



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina 57/2, Nr.18 Tiranë,

Tel/Fax 04 2226814; 22268142

Nr. 269/4 Prot.

Tiranë më 20.07.2016

V E N D I M
Nr. 82, datë 20.07.2016

**Mbi përfundimin e procedimit administrativ,
filluar me Urdhërin nr. 269 prot., datë 09.03.2016**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, dhe neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative", të cilët lejohen të veprojnë në këtë rast prej nenit 185, të ligjit 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit të dhënë prej Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve administrative, të kryera nga Institucioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për rekrutimin dhe emërimin në detyrë të disa nëpunësve të nivelit të mesëm drejtues.

VËREJ SE,

Shkak për fillimin e kësaj procedure është bërë një informacion protokolluar pranë Komisionerit, me nr. 115, prot., datë 12.02.2016, si dhe marrja dijeni për publikimin e konkluzioneve të një raporti të Kontrollit të Lartë të Shtetit, të bëra publike në faqet e internetit të subjekteve "Syri.net" dhe "Radio Lushnja". Në informacionet e përmendura më sipër, ngrihej pretendimi se, rekrutimi dhe emërimi në detyrë i disa nëpunësve të nivelit të mesëm drejtues, është kryer në kundërshtim me kërkesat e ligjit për shërbimin civil, me arsyetimin se këta kandidatë nuk mund të kualifikoheshin për pjesmarje në konkurrim për shkak të mosplotësimit të kriterëve të posaçme.

Nga përmbajtja e këtyre informacioneve, lindën dyshime të arsyeshme në lidhje me mundësinë e ekzistencës së shkeljeve të lejuara, në kryerjen e procedurave të rekrutimit dhe emërimit në detyrë, të:

- ***** - Drejtor i Drejtorisë Juridike;
- ***** - Drejtor i Drejtorisë së Investigimit të Brendshëm
(Antikorrupsion)

- ***** - Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor;
- ***** - Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut;
- ***** - Drejtor i Drejtorisë të Burimeve Njerëzore;

të cilat mund të kenë ndikuar në mosrespektimin e parimeve të shërbimit civil, mungesës së transparencës, emërimit sipas meritës, sigurimit të shanseve të barabarta, mosdiskriminimit të konkurrentëve, etj., e për këtë arsye, nga ana e Komisionerit u vendos që të verifikohet ky rast.

Nga shqyrtimi i akteve të administruara në dosjen që pasqyron hetimin administrativ në këtë rast, rezulton si më poshtë:

Nëpërmjet urdhrit nr. 15, datë 31.10.2013 *“Për shpalljen e vendeve të lira të punës në Administratën Tatimore Qëndrore”*, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, në përputhje me parashikimet ligjore, është urdhëruar marrja e masave për rekrutimin e personelit të Administratës Tatimore Qëndrore, për disa pozicione pune të lira ku ndër të tjera edhe për pozicionet e punës:

- *Drejtor i Drejtorisë Juridike*
- *Drejtor i Drejtorisë së Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion)*
- *Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor*
- *Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut.*

Duke trajtuar nga pikëpamja formale/procedurale, mënyrën e zhvillimit të procesit të konkurrimit, nga momenti i shpalljes së tij deri në shpalljen e fituesit, vërehet se, në përgjithësi është zhvilluar në respektim të rregullave, afateve dhe kërkesave që përcaktonte ligji nr. 8549, dt. 11.11.1999 *“Statusi i nëpunësit civil”*, i cili ishte efektiv në atë kohë.

Konkretisht, është vepruar si më poshtë:

Nëpërmjet aktit administrativ nr. 15/2, datë 31.10.2013, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, është urdhëruar botimi i njoftimit për pozicionet e lira të punës në pesë ditë të njëpasnjëshme në gazetën *“Shqip”* dhe *“Panorama”*, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.8549, dt. 11.11.1999 *“Statusi i nëpunësit civil”*, i cili ishte efektiv në atë kohë. *(Nga ana e institucionit është paraqitur një kopje e gazetës “Shqip”, nga përmbajtja e së cilës provohet se publikimi i njoftimit për pozicionet e lira të punës është kryer rregullisht, sipas urdhërit të mësipërm).*

Me aktin administrativ nr. 27, datë 16.12.2013, *“Për publikimin e listës me konkurrentët e skualifikuar”*, nga ana e njësisë së burimeve njerëzore është publikuar lista e konkurrentëve të skualifikuar, publikim i cili është realizuar sipas ligjit, në dy gazetën me qarkullim më të madh.

Më tej, me shkresën nr. 17747/4 prot., datë 20.12.2013, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1184, datë 20.08.2008 *“Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit dhe të emërimit, të afateve të kalimit nga një nivel më i ulët në një nivel më të lartë karriere dhe për marrjen e masave disiplinore për punonjësit e Administratës Tatimore Qëndrore”*, i ndryshuar, Ministri i Financave, ka miratuar ngritjen e Komitetit *ad-hoc* të testimit, për kategorinë A, B, C1, C2 dhe C3, ku janë përfshirë edhe pozicionet e punës objekt i këtij hetimi.

Në vijim të këtyre procedurave, Komiteti *ad-hoc* i testimit ka mbajtur procesverbalin e datës 24.12.2013, ora 9:00, mbi zhvillimin e testimit me shkrim për kategorinë A dhe B, ku janë përfshirë edhe pozicionet e punës “*Drejtor Drejtorie*” në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Nga përmbajtja e procesverbalit rezulton se Komiteti *ad-hoc*, kishte administruar më parë një listë me konkurrentët e kualifikuar e cila ishte shpallur nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Nga lista rezulton se kandidatët ishin kualifikuar sipas pozicioneve të veçanta të punës, dhe sipas kësaj ndarje ato do të merrnin pjesë në fazën e dytë, atë të testimit me shkrim.

Në procesverbal është sqaruar se, nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore ishte treguar kujdes për respektimin e kërkesës së ligjit të kohës për numrin minimal të lejueshëm të konkurrentëve për secilin pozicion pune. Rezulton se nga ana e Komiteti *ad-hoc*, kandidatëve në testimin me shkrim, u është administruar, dokumenti i identifikimit, si dhe nënshkrimi, çka provon edhe pjesëmarrjen e tyre në testim.

Më tej rezulton se është respektuar edhe procedura e shpalljes së listës së kandidatëve fitues të testimit me shkrim dhe është realizuar procesi i testimit me gojë. Sipas procesverbalit të datës 30.12.2013, Komiteti *ad hoc*, ka shpallur listën me kandidatët fitues për çdo pozicion pune, të cilën e ka dërguar tek eprori direkt, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, për të ushtruar të drejtën e përzgjedhjes.

Me vendimin nr. 2 datë 14.01.2014, Drejtori i Përgjithshëm i DPT, duke u mbështetur mbi këtë procesverbal, ka vendosur të emërojë kandidatët fitues për çdo pozicion pune të shpallur për konkurrim, e midis të tjerave edhe për katër pozicionet e punës të sipërcituara. Ky vendim, provohet të jetë shpallur edhe në faqen zyrtare të internetit të institucionit, si dhe në gazetën “*Shqip*” të datës 15 janar 2014.

Pozicionet e punës “*Drejtor Drejtorie pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve*”, për të cilët është zhvilluar ky hetim administrativ, referuar pikës 3/c të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1184, datë 20.08.2008 “*Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit dhe të emërimit, të afateve të kalimit nga një nivel më i ulët në një nivel më të lartë karriere dhe për marrjen e masave disiplinore për punonjësit e Administratës Tatimore Qendrore*”, i ndryshuar, përfshihen në kategorinë “A”, e cila i përgjigjej klasifikimit nëpunës civil i nivelit të mesëm drejtues, sipas ligjit të kohës.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm, rezulton se gjatë procedurës së realizuar për plotësimin e këtyre pozicioneve, konstatohet se janë lejuar edhe disa parregullsi, të cilat konsistojnë në anën formale të procesit, të tilla si mangësi në lidhje me saktësinë për kohën dhe vendin e rekrutimit, pasaktësi në listat e konkurrentëve, raste kur përbri emrit të konkurentit, mungon nënshkrimi i tij, etj.

Duke i analizuar këto shkelje, si dhe nisur nga rëndësia e tyre, në raport me tërësinë e veprimeve administrative të kryera gjatë procesit të rekrutimit në këtë rast që po analizojmë, vlerësohet se ato kanë karakter formal dhe nuk e çenojnë thelbin e procesit, për ta vlerësuar atë si të pavlefshëm.

Për më tepër, ky përfundim gjendet koherent, edhe me vullnetin aktual të ligjvënësit, i cili ka vendosur që, statusin e nëpunësit civil, ta përfitojnë për shkak të ligjit, të gjithë ata nëpunës, të

cilët fillimi i efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, i ka gjetur në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, pavarësisht nga mënyra se si janë marrë në punë.

Neni 67, i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, përcakton në mënyrë të shprehur se :

“1.Nëpunësit civilë ekzistues, punonjësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione të shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që janë rekrutuar sipas një procedure pranimi konkurruese, të ngjashme me atë të përcaktuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, apo që janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se 1 vit, janë, për shkak të ligjit, nëpunës civilë.

2. Nëpunësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione, pjesë të shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, janë nëpunës civilë në periudhë prove dhe për ta zbatohen dispozitat e nenit 24 të këtij ligji. Periudha e provës fillon nga fillimi i shtrirjes së efekteve të këtij ligji.

3. Deklarimi i përfundimit të marrëdhënies së punësimit, sipas pikës 2 të këtij neni, bëhet nga njësia përgjegjëse, brenda 30 ditëve nga përfundimi i afatit 1-vjeçar.

4. Deklarimi i statusit të punësimit, sipas pikave 1, 3 dhe 4 të këtij neni, bëhet nga njësia përgjegjëse pas verifikimit të procedurës së punësimit”.

Institucioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, referuar ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, bën pjesë në listën e institucioneve të administratës shtetërore (numër 46), për pasojë edhe pozicionet e punës “drejtor drejtorie” pranë DPT, janë pozicione pune pjesë e shërbimit civil.

Për këtë arsye, për punonjësit që punonin në këto pozicione pune, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (pra në datën 26.02.2014), Njësia Përgjegjëse kishte detyrimin ligjor për të realizuar procesin e deklarimit të statusit të punësimit, mbështetur në dispozitën e cituar më sipër, duke verifikuar faktin nëse punonjësit i plotësonin kërkesat e përgjithshme dhe të posaçme për pozicionet që mbanin, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore si më poshtë:

- Ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, neni 21;
- Vendimi nr. 1184, datë 20.08.2008, i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit e të emërimit, të afateve të kalimit nga një nivel më i ulët në një nivel më të lartë karriere dhe për marrjen e masave disiplinore për punonjësit e Administratës Tatimore Qendrore”, i ndryshuar (aneksi 1);
- Vendimi nr. 545, dt. 11.8.2011, i Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, Zëvendësministrit dhe nëpunësve të Kabineteve, në Kryeministri, Aparatet e Ministrive të Linjës, Administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, Gjykatën e Lartë, disa Institucione të Pavarura, Institucionet në varësi të Kryeministrit, Institucionet në Varësi të Ministrave të linjës dhe Administratën e Prefektit”, i ndryshuar me Vendimin nr. 589, datë 17.7.2013 “Për disa ndryshime në Vendimin nr.545, datë

11.8.2011”; Lidhja nr. 6/9 “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e sistemit të tatimeve”;

- Formulari i përshkrimit të objektivave të punës për pozicionin ku ishte i emëruar punonjësi.

E analizuar në këtë këndvështrim, dinamika e marrëdhënies së punësimit për punonjësit në fjalë, referuar dokumentacionit të administruar gjatë verifikimit të rastit nga dosjet personale të cilat ndodhen në institucionin e DPT, rezulton si më poshtë:

1. Rasti i punonjësës *** “Drejtor i Drejtorisë Juridike”.**

Punonjësja ***** , është emëruar përkohësisht në pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut” në D.P.Tatimeve, deri në përfundim të procedurave të konkurrimit për këtë pozicion pune, me vendimin nr. 2264, datë 09.10.2013, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

Më tej, rezulton se me urdhërin nr. 2300, datë 28.10.2013, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, ajo është liruar nga ky pozicion dhe është emëruar përkohësisht në pozicionin e punës “Drejtor i Drejtorisë Ligjore” pranë DPT, përsëri me motivacionin “deri në përfundim të procedurave të konkurrimit për këtë pozicion pune”.

Më pas, është kryer konkurrimi për këtë pozicion pune, në datën 24.12.2013 dhe punonjësja ***** , ka rezultuar si kandidati fitues në këtë procedurë. Në vijim të procedurave ligjore për plotësimin e vendit të punës, pas një procedure konkurrimi, me vendimin nr. 47, dt. 16.01.2014, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, ajo është emëruar në detyrën e Drejtorit të Drejtorisë Ligjore.

Në këto rrethana, momenti i fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e ka gjetur këtë punonjëse në një pozicion pune, pjesë e shërbimit civil në institucionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, i cili edhe më parë ka qenë pjesë e shërbimit civil.

Konstatohet se, në datën 30.10.2014, Departamenti i Administratës Publike, me cilësinë e Njesisë Përgjegjëse, ka nxjerrë aktin me nr. 1603/272, dt. 30.10.2014, duke e deklaruar atë nëpunëse civile në pozicionin “Drejtores e Drejtorisë Ligjore”. Nisur nga periudha e punësimit të kësaj punonjëseje, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil, në këtë pozicion, vlerësohet se ky deklarim i statusit të punësimit nuk është kryer në përputhje me kërkesat e nenit 67, pika 3, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pasi, nëse do ta analizojmë rastin në lidhje me këtë dispozitë, kjo punonjëse kishte më pak se një vit pune në pozicionin e “Drejtorit të Drejtorisë Ligjore” pranë DPT dhe për këtë arsye, statusi i saj duhet të deklarohet si “nëpunëse civile në periudhë prove” dhe jo “nëpunëse civile”, siç ka dalë në fakt.

Po kështu, në të njëjtin përfundim do të arrihej edhe nëse do ta analizonim rastin në këndvështrim të dispozitave të ligjit të mëparshëm nr. 8549 dt. 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” i cili në nenin 14 të tij, siç lejon dispozita e nenit 68, paragrafi 2, të ligjit aktual nr. 152/2013 i ndryshuar, ku përcaktohet se procedurat e nisura me ligjin e mëparshëm do të përfundojnë sipas atij ligji. Nisur nga data e fillimit të provës 16.01.2014 dhe data e deklarimit të statusit 30.10.2014, del përfundimi se periudha e provës nuk ishte plotësuar.

Ndërkohë, nga dokumentacioni i gjendur në dosjen e personelit të kësaj punonjëseje, konstatohet se faktikisht është treguar kujdes për të plotësuar detyrimet ligjore të periudhës së provës, pasi,

kjo punonjëse është trajtuar faktikisht si punonjëse në periudhë prove, ç`ka provohet me aktin nr. 8191/13, datë 27.03.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, i cili vetëm në përfundim të kësaj periudhe, bazuar në vlerësimin e rezultateve individuale pozitive në punë dhe përfundimin me sukses të trajnimit pranë Shkollës së Administratës Publike (ASPA), e ka konfirmuar punonjësen si nëpunëse civile.

Po kështu, nëse analizojmë kriteret e punësimit, në momentin e deklarimit të statusit të punësimit, ato përputhen me kriteret e parashikuara në formularin e përshkrimit të punës, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit të ri.

Nga gjithë analiza e përshkruar më sipër, arrihet në përfundimin se, nëpunësja ***** , i plotëson kushtet për të qenë pjesë e shërbimit civil, në pozicionin e punës “*Drejtor i Drejtorisë Ligjore*”, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, si në aspektin e kërkesave të përgjithshme, ashtu edhe të atyre të posaçme, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil.

Ndërkohë, nga ana e Departamentit të Administratës publike, duhet të ndryshohet akti i deklarimit të statusit të punësimit, duke e konsideruar punonjësen si nëpunëse civile në periudhë prove dhe të nxirret një akt i ri i deklarimit të statusit, pas administrimit të dokumentacionit konfirmimit si e tillë, nga ana e eprorit direkt.

2. Rasti i punonjësit *** “Drejtor i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm”.**

Punonjësi ***** , është emëruar përkohësisht në administratën tatimore, me vendimin nr. 2281, datë 22.10.2013, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, në pozicionin e punës “*Drejtor i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm*” në DPT, për një afat kohor 3-mujor, deri në përfundim të procedurave të konkurrimit për këtë pozicion pune. Mbas kryerjes së procedurës të konkurrimit, në dt. 24.12.2013, punonjësi ***** , ka rezultuar fitues për pozicionin e “*Drejtorit të Drejtorisë së Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion)*” në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Sipas vendimit nr. 70, datë 16.01.2014, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, ky punonjës është liruar nga detyra “*Drejtor i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm*”, ku ishte i punësuar me kontratë të përkohshme dhe është emëruar në pozicionin e “*Drejtorit të Drejtorisë së Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion)*”, për të cilin ai kishte konkuruar.

Një muaj më pas, ndonëse punonjësi ishte duke kryer periudhën e provës në pozicionin për të cilin kishte konkuruar, me vendimin nr. 345, datë 25.01.2014, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, ai komandohet në pozicionin e punës “*Drejtor i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm*”, në DPT dhe më tej, me vendimin nr. 498, datë 25.02.2014, lirohet nga pozicioni i “*Drejtorit të Drejtorisë së Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion)*”, duke u emëruar përfundimisht, në pozicionin e “*Drejtorit të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm*”, në DPT.

Duke analizuar rrethanat e parashtruara më sipër, konstatohet se në kryerjen e kësaj lëvizje në detyrë, e ngjashme me një lëvizje paralele, (*pasi jemi para dy pozicioneve pjesë e shërbimit civil, të një niveli nëpunësie*), nuk janë respektuar kërkesat procedurale të përcaktuara në nenin 15, të ligjit nr. 8549, dt. 11.11.1999 “*Statusi i nëpunësit civil*” dhe Vendimit nr. 342 dt. 14.7.2000 “*Për lëvizjen paralele dhe ngritjen në detyrë të nëpunësit civil*”, të cilat ishin efektive në atë kohë.

Por nga ana tjetër, marrëdhënia e punësimit në pozicionin e ri, tashmë rregullohet sipas nenit 67, pika 4, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, pasi një ditë më pas, në datën 26.02.2014, kanë filluar efektet juridike të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar

dhe nëpunësi përmbushte kushtet për t'u deklaruar nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin e punës “Drejtor i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm” në DPT. Ky punonjës kishte arsimimin e përshtatshëm dhe vjetërsinë e duhur për këtë pozicion, pasi kishte punuar për një periudhë prej, më shumë se 8 vjetësh (1997 – 2005), në pozicione pune me natyrë të ngjashme, në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave. Aktualisht, në momentin që kryhet ky inspektim, ai ka plotësuar dhe kushtin tjetër ligjor, për të kryer detyrën e drejtuesit të njësisë së auditimit, duke kryer trajnimin përkatës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm dhe në përfundim të kursit, është pajisur me çertifikatën nr. 1840, dt. 20.05.2015, si “Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik”.

Pas përfundimit të periudhës së provës, mbi bazën e vlerësimit të rezultateve në punë, si dhe të testimit pranë Shkollës së Administratës Publike, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, ka nxjerrë aktin e konfirmimit si nëpunës civil, nr. 3142, datë 10.02.2015 “Për konfirmimin si nëpunës civil pas përfundimit të periudhës së provës”, për punonjësin ******, në pozicionin e “Drejtorit të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm në DPT”.

Konstatohet se veç sa sipër, ky punonjës, me aktin administrativ nr. 3133/2, datë 03.08.2015, të Departamentit të Administratës Publike, është rikonfirmuar dhe regjistruar në regjistrin përkatës si nëpunës civil, në pozicionin e punës “Drejtor i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm”, në DPT.

Nisur nga periudha e punësimit të këtij punonjësi, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil, rezulton se ky deklarim nuk është kryer në përputhje me parashikimet e nenit 67, pika 3, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pasi, nëse Njësia Përgjegjëse do të kishte vepruar brenda afatit të parashikuar nga Kreu IV, i Vendimit nr. 116 dt. 05.03.2014 (i ndryshuar me VKM 532 dt. 06.08.2014) do ta gjente këtë nëpunës pa mbushur periudhën një vit të punësimit dhe në këto kushte nuk do të fitonte statusin e punësimit si nëpunës civil, por si nëpunës civil në periudhë prove.

DAP, ka vepruar tej afateve ligjore për të deklaruar statusin e punësimit të këtij punonjësi, ç`ka ka sjellë ndërkohë përfundimin e procesit të periudhës së provës, dhe konfirmimin si nëpunës civil prej eprorit direkt.

Nga gjithë sa u analizua më sipër, arrihet në përfundimin se fillimi i efekteve juridike të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, i ka krijuar mundësi nëpunësit ******, që për shkak të ligjit, të përfitojë për të hyrë në shërbimin civil, në pozicionin e “Drejtorit të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm në DPT”. Në momentin e konfirmimit të statusit të punësimit nga ana e Njesisë Përgjegjëse, ky punonjës ka plotësuar edhe kushtin ligjor të pajisjes me çertifikatën e auditit, e për këtë arsye, marrëdhënia e tij e punësimit, vlerësohet ligjërisht e rregullt.

3. Rasti i punonjësës *** “Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor”.**

Duke u nisur nga aktet administrative të verifikuara në dosjen personale të punonjësës ******, rezulton se, me vendimin nr. 2312, datë 31.10.2013, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, kjo punonjëse është emëruar përkohësisht në pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në DPT”, deri në përfundimin e procedurave të konkurrimit për këtë pozicion pune. Pas përfundimit të procedurave të konkurrimit, kjo punonjëse rezultoi fituese dhe me

vendimin nr. 71, datë 16.01.2014 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, është emëruar në pozicionin e punës “*Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në DPT*”.

Konstatohet se Departamenti i Administratës Publike, me aktin administrativ nr. 1603/329, datë 30.10.2014, e ka deklaruar punonjësen ***** në grupimin “*nëpunës civil*”, në pozicionin e punës “*Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor*” në DPT.

Rezulton se me vendimin nr. 356, datë 30.04.2015, të Komisionit të Disiplinës, ndaj kësaj punonjëseje është marrë masa disiplinore “*Largim nga shërbimi civil*”, pasi kjo nëpunëse, e caktuar si përfaqësuese zyrtare e DPT në grupin ndërinstitucional të punës për EITI Shqipëri, nuk ka pasur angazhimin e duhur gjatë vitit 2014, duke sjellë pasoja të rënda në ecurinë e këtij procesi.

Duke qenë se kjo punonjëse është larguar nga detyra, pra nuk është më pjesë e shërbimit civil, vlerësohet e panevojshme analiza e mëtejshme e këtij rasti, nga ana e Komisionerit.

4. Rasti i punonjësës *** “Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut”.**

Nga tërësia e dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, rezulton se, punonjësja ***** , në datën 14.10.2013, është emëruar në mënyrë të përkohshme në pozicionin e punës “*Përgjegjëse në Sektorin e Taksave, Tatimeve, Kontributeve Direkte dhe Marrëveshjeve Ndërkombëtare*”, në Drejtorinë Teknike, pranë DPT.

Më pas, në dt. 28.12.2013, provohet se ajo ka marrë pjesë në konkurrimin e hapur, që është zhvilluar për pozicionin e punës “*Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut*”, në përfundim të të cilit është shpallur fituese dhe me vendimin nr. 69, datë 16.01.2014, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, është emëruar në këtë pozicion “*nëpunëse civile në periudhë prove*”.

Në këtë rast, meqënëse, ajo ka marrë pjesë në një konkurrim të hapur, për të cilin plotësonte kriteret ligjore dhe eksperiencën e përgjithshme në punë që kërkonte pozicioni, veprimi administrativ i kryer vlerësohet një veprim i rregullt.

Edhe me fillimin e efekteve të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në bazë të nenit 67 pika 4, të këtij ligji, nëpunësja ***** , ka përfutuar rishtas statusin “*nëpunës civil në prove*”, për pozicionin “*Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut*” në DPT.

Departamenti i Administratës Publike, me aktin administrativ nr. 1603/330, datë 31.10.2014, e ka deklaruar punonjësen ***** , si “*nëpunëse civile në periudhë prove*”. Aktualisht, në përfundim të periudhës së provës, pas rezultateve pozitive në vlerësimin e punës dhe në trajnimin e kryer me sukses në ASPA, me aktin nr. 8191/4 prot., datë 27.03.2015 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, është bërë konfirmimi i saj si nëpunëse civile në pozicionin “*Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut*”, prandaj marrëdhënia e punësimit të nëpunësës ***** , vlerësohet e rregullt.

5. Rasti i punonjësës *** “Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore”.**

Sipas akteve administrative të verifikuara në dosjen personale të punonjësës ***** , rezulton se me vendimin nr. 2272, datë 10.10.2013, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, ajo është emëruar përkohësisht në pozicionin “*Inspektore Kartoteke në Sektorin e Mbledhjes së*

Informacionit (inteligjencës)”, në Drejtorinë e Hetimit Tatimor, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, deri në përfundim të procedurave të konkurrimit për këtë pozicion.

Më pas, me vendimin nr. 379, datë 31.01.2014, ajo lirohet nga kjo detyrë dhe emërohet përkohësisht në pozicionin e punës *“Drejtoresë së Burimeve Njerëzore”*, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, deri në përfundim të procedurave të konkurrimit për këtë pozicion pune.

Fillimi i efekteve të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, e ka gjetur punonjësen ***** të punësuar në pozicionin *“Drejtoresë së Burimeve Njerëzore”*, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, për një periudhë më pak se një vit, prandaj bazuar në nenin 67, pika 4, të këtij ligji, Departamenti i Administratës Publike, me të drejtë, nëpërmjet aktit nr. 1603/289, datë 30.10.2014, e ka deklaruar punonjësen ***** *“nëpunëse civile në periudhë prove”*.

Duke hetuar në lidhje me faktin e pretenduar, nëse kjo punonjëse e përmbushte kriterin e eksperiencës në punë, që kërkohej prej legjislacionit tatimor në përgjithësi dhe Vendimit nr. 1184, datë 20.08.2008, të Këshillit të Ministrave *“Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit dhe të emërimit, të afateve të kalimit nga një nivel më i ulët në një nivel më të lartë karriere dhe për marrjen e masave disiplinore për punonjësit e Administratës Tatimore Qendrore”*, në veçanti, rezulton se në momentin e emërimit ajo kishte mbi dy vjet vjetërsi në punë, në pozicione analoge. Nisur nga kjo, vlerësohet se Departamenti i Administratës Publike, me të drejtë ka pranuar njësimin e llojit të eksperiencës dhe ka bërë deklarinimin e statusit të punësimit, si më sipër.

Në përfundim të periudhës së provës, pas vlerësimit pozitiv të rezultateve në punë dhe pas përfundimit me sukses të trajnimit specifik në Shkollën e Administratës Publike (ASPA), me aktin nr.8191/15 prot., datë 27.03.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, është realizuar edhe konfirmimi i saj si *“nëpunës civil”*, cilësi të cilën e gëzon edhe aktualisht.

Nisur nga rrethanat e mësipërme, marrëdhënia e punësimit të nëpunëses ***** në pozicionin *“Drejtoresë së Burimeve Njerëzore”*, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, vlerësohet marrëdhënie e mbështetur ligjërisht.

Në përfundim të këtij hetimi administrativ, pas shqyrtimit të të gjitha akteve shkresore të sipërcituara, përmes të cilave janë materializuar procedurat e pranimit në shërbimin civil, apo procedurat ligjore të përfitimit të statusit të nëpunësit civil për shkak të ligjit, të nëpunësve :

*****, emëruar në pozicionin e punës *“Drejtor i Drejtorisë Juridike”*;

*****, emëruar në pozicionin e punës *“Drejtor i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm”*;

*****, emëruar në pozicionin e punës *“Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut”*;

*****, emëruar në pozicionin e punës *“Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore”*;

në institucionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, konkludojmë se shkeljet e lejuara në procesin e pranimit të tyre në punë, janë të karakterit formal dhe nuk janë të asaj natyre që të përbëjnë shkak për të cënuar marrëdhëniet e tyre të punësimit.

Ky hetim administrativ është zhvilluar në përputhje me kërkesat e neneve 13 e 14, të ligjit nr.8549, dt. 11.11.1999 *“Statusi i nëpunësit civil”*; nenet 67 e 68, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*; dhe me ligjin nr. 8485 dt. 12.05.1999 *“Kodi i Procedurave Administrative të*

RSH”, i cili, vazhdon funksionin në bazë të nenit 185 të ligjit 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të RSH*” pasi procedurat kanë filluar me kodin e mëparshëm dhe duhet të përfundojnë me atë ligj.

Për këto arsye:

Mbështetur në nenet 16, pika 6 dhe 34, të Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17 dt. 11.03.2015 të Komisionerit,

V E N D O S A:

1. Përfundimin e procedimit administrativ, filluar me urdhrin nr. 269 dt. 09.03.2016 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “*Për verifikimin e disa rasteve të emërimit të bëra publike në faqet e internetit “Syri.net” dhe subjekti radiofonik vendor “Radio Lushnja” me shkelje të pretenduara lidhur me procedurat e pranimit në shërbimin civil të disa nëpunësve të nivelit të mesëm drejtues të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve*” pasi në kryerjen e këtyre veprimeve administrative nuk vërehen shkelje të kërkesave të ligjit.
2. Të njoftohen për këtë vendim, Departamenti i Administratës Publike dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K O M I S I O N E R I

Pranvera STRAKOSHA